



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 19.04.2023

Nr: 62

Ora: 19:00

VENDIM

**PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS ANKIMORE NR. 51, DATË 18.04.2023, DEPOZITUAR NGA KOALICIONI
“BASHKË FITOJMË”**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 19.04.2023, me pjesëmarrjen e:

Ledio BRAHO - **Relator**
Elvin LAKO - **Anëtar**
Elvis ÇEFA - **Anëtar**
Ilirjan RUSMALI - **Anëtar**
Koli BELE - **Anëtar**

Shqyrtoi çështjen me:

ANKUES: Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, përfaqësuar nga z. Franc Nuri

PALË E INTERESUAR: “Partia Demokratike e Shqipërisë”, përfaqësuar nga z. Indrit Sefa

OBJEKT:

1. Kundërshtimi i vendimit nr. 360, datë 15.04.2023 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për kandidatët për kryetar bashkie, Bashkia Tiranë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

2. Kundërshtimi i i vendimit nr. 363, datë 15.04.2023 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për kandidatët për kryetar bashkie në 60 bashki, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

3. Shfuqizimi i këtyre vendimeve, duke vendosur: Ndryshimin e përmbajtjes së fletës së votimit për kandidatët për kryetar bashkie në 61 bashkitë e vendit, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, duke hequr logon e partive dhe të koalicioneve, nga përmbajtja e fletës së votimit pr kandidatët për kryetar bashkie”.

BAZË LIGJORE:

Nenet 21/b dhe 123/1 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Rrethanat e çështjes:

1. Në seancën publike të datës 15.04.2023, me vendimet nr. 360 dhe nr. 363, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vendosi miratimin e fletëve të votimit për kandidatët për kryetar bashkie në 61 bashki.
2. Kundër këtyre vendimeve ka paraqitur kërkesë ankimore subjekti zgjedhor koalicioni “Bashkë Fitojmë”, e cila ka kërkuar shfuqizimin e vendimit nr. 360, datë 15.04.2023 “Për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për kandidatët për kryetar bashkie, bashkia Tiranë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”; shfuqizimin e vendimit nr. 363, datë 15.04.2023 “Për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për kandidatët për kryetar bashkie në 60 bashki për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”, si dhe ndryshimin

e përmbajtjes së fletës së votimit, duke kërkuar heqjen e logove të partive dhe koalicioneve nga përmbajtja e fletës së votimit për kandidatët për kryetar bashkie.

3. Kërkesa ankimore nr. 51 iu paraqit KAS-it, i cili vendosi pranimin për shqyrtim të saj me relator z. Ledio Braho. KAS-i caktoi seancën e shqyrtimit në datën 19.04.2023, ora 19:00. Në seancë ishin të pranishëm administrata e KQZ-së, përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm z. Ylli Merkaj, përfaqësuesi i palës ankimuese koalicioni “Bashkë Fitojmë” z. Franc Nuri, si dhe përfaqësuesi i palës së interesuar z. Indrit Sefa.
4. Ankuesi i koalicionit “Bashkë Fitojmë” z. Nuri pretendoi se Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka anashkaluar kërkesat e tyre të bëra në seancën publike të datës 15.04.2023. Vendimi i Komisionerit mbi fletën e votimit për kryetar bashkie mund të sjellë konfondim të zgjedhësit në ditën e zgjedhjeve lokale, si dhe është e panevojshme pajisja me logo (emblemë) përmbri fletës së votimit dy herë. Emri i kryetarit të bashkisë ka më shumë rëndësi sesa logoja bashkangjitur, pasi ata përfaqësojnë veten e tyre, si individë, dhe pse janë të mbështetur nga partia politike. Gjithashtu nga praktika e viteve 2015 dhe 2019, në fletën e votimit nuk janë përfshirë logot e subjekteve zgjedhore. Dispozita e përcaktuar në nenin 98, pikën 3, të Kodit Zgjedhor nuk parashikon që fleta e votimit të ketë logon e koalicionit.
5. Në seancën publike të shqyrtimit administrativ, mori pjesë si palë e interesuar përfaqësuesi i “Partisë Demokratike të Shqipërisë” z. Indrit Sefa, i cili kërkoi rrëzimin e kërkesës ankimore, si të pabazuar në ligj. Praktika e mëvonshme e KQZ-së mbi këto fletë votimi e kanë të përfshirë logon përmbri emrit, vendime këto që nuk janë ankimuar nga subjektet zgjedhore, gjithashtu neni 98 i Kodit Zgjedhor cakton qartazi se sigla e subjektit zgjedhor duhet të jetë pjesë identifikuese e detyrueshme në fletën e votimit.
6. KAS-i mori në shqyrtim dhe administroi:
 - Kërkesën ankimore nr. 51, datë 18.04.2023
 - Vendimi nr. 360, datë 15.4.2023, “Për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për kandidatët për kryetar bashkie, bashkia Tiranë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”
 - Vendimi nr. 363, datë 15.4.2023, “Për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për kandidatët për kryetar bashkie në 60 bashki, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”

- Procesverbali i zbardhur i seancës publike të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, datë 15.04.2023

Në përfundim të shqyrtimit administrativ dhe të vlerësimit të provave dhe pretendimeve të palëve,

KAS-i konstatoi :

1. Vendimet e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 360 dhe nr. 363 të datës 15.04.2023 kanë miratuar përmbajtjen e fletës së votimit për kandidatët për kryetar bashkie, bashkia Tiranë, dhe për kryetar bashkie në 60 bashkitë e tjera, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.
2. Ankuesi, koalicioni zgjedhor “Bashkë Fitojmë” ka kërkuar heqjen e “logove të subjekteve zgjedhore” me argumentin se *“neni 98, pika 3 e Kodit Zgjedhor nuk parashikon që Fleta e Votimit të ketë logon e koalicionit, si dhe duke marrë shkas nga praktika e ndjekur deri më tani për zgjedhjet e tjera të organizuara nga KQZ”*.
3. KAS-i e ka trajtuar gjerësisht çështjen e përmbajtjes së fletës së votimit në vendimin e tij nr. 61, datë 19.04.2023 “Për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 50, datë 17.04.2023, depozituar nga “Partia Demokratike e Shqipërisë”. Kodi Zgjedhor ka përcaktuar kërkesat ligjore që duhet të plotësojë fleta e votimit në nenet 97 dhe 98 të tij. Një pjesë e kërkesave janë specifike në varësi të llojit të zgjedhjeve, por shumica e tyre janë të përbashkëta, pavarësisht nga lloji i zgjedhjeve dhe pavarësisht se për cilin organ bëhet votimi.
4. KAS-i çmon se pika 3 e nenit 98 të Kodit Zgjedhor që parashikon se *“Emrat e subjekteve zgjedhore vendosen në fletën e votimit, sipas rendit të përcaktuar në mënyrë të rastësishme nga shorti. Përbri emrit të partisë vendoset sigla, shkronja nistore dhe emri i kryetarit të partisë. Çdo subjekti që renditet në fletën e votimit i korrespondon hapësira përkatëse për shënimin e votës nga zgjedhësi”* është e vlefshme për të gjitha llojet e zgjedhjeve dhe për të gjitha llojet e fletëve të votimit. Elementët e përcaktuar në fjalinë e dytë të kësaj pike janë të detyrueshme për t’u përfshirë në fletën e votimit dhe Komisioneri nuk ka hapësirë diskreciale në zbatimin e kësaj fjalie. Nëse ligjvënësi do kishte pasur për qëllim që për zgjedhjet e qeverisjes vendore të përcaktonte elemente të ndryshme në secilën prej fletëve (një për

kryetarin e njësisë së qeverisjes vendore dhe një për këshillin e bashkisë), atëherë do të bënte parashikime konkrete për to, siç ka bërë në rastin e nenit 97 pikat 2¹ dhe 3/1² apo në rastin e nenit 98 pika 4³. Sipas arsytimit të mësipërm kuptojmë se elementet e parashikuar në nenin 98 pika 3 të K.Zgjedhor, janë të detyrueshëm për secilën nga fletat e votimit për organet e qeverisjes vendore.

5. Megjithatë, edhe sikur të arsyetonim që elementi i siglës së subjektit zgjedhor nuk është i detyrueshëm për t'u pasqyruar në fletën e votimit për kryetarin e qeverisjes vendore, ky argument është i pamjaftueshëm për KAS që të ndryshojë vendimet e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve objekt ankimi, pasi në këtë mënyrë do të cënonte parimin e ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit.

Më konkretisht pika 3 e nenit 3 të K.Pr.Administrative përkufizon "*diskrecionin e organit publik*" si "*e drejta e këtij të fundit për të ushtruar autoritet publik për të përmbushur një qëllim të ligjshëm, në rastet kur ligji parashikon pjesërisht modalitetet për të arritur këtë, duke i dhënë hapësirë vlerësimi zgjedhjeve të organit publik*". Ndërkohë neni 11 i K.Pr.Administrative, e sanksionon në mënyrë të detajuar parimin e ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit duke parashikuar se:

"Diskrecioni ushtrohet ligjërisht kur ai është në përputhje me kushtet e mëposhtme:

- a) është i parashikuar me ligj;*
- b) nuk tejkalon kufijtë e ligjit;*
- c) zgjedhja e organit publik është bërë vetëm për të arritur objektivin për të cilin është lejuar diskrecioni dhe është në përputhje me parimet e përgjithshme të këtij Kodi; dhe;*
- ç) zgjedhja nuk përbën një shmangie të pajustificuar nga vendimet e mëparshme të marra nga i njëjti organ në raste të njëjta apo të ngjashme".*

¹ "2. Për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore zgjedhësi voton me dy fleta votimi me formë të njëjtë dhe me ngjyra të ndryshme, një për kryetarin e njësisë së qeverisjes vendore dhe një për këshillin e bashkisë".

² "3/1. Ngjyra e fletës në zgjedhjet e qeverisjes vendore është e njëjtë në të dyja anët e saj".

³ "4. Fleta e votimit për zgjedhjet për Kuvendin duhet të përmbajë hapësirën e posaçme për ushtrimin e votimit parapëlqyes për kandidatët e subjektit zgjedhor. Mënyra e votimit parapëlqyes përcaktohet nga KQZ-ja në varësi nga numri i subjekteve pjesëmarrëse në zgjedhje, duke respektuar kushtin që informacioni i përcjellë nga fleta e votimit të mos jetë tejet i ngarkuar, konfigurimi i fletës të jetë i qartë e i kuptueshëm për zgjedhësin dhe zgjedhësi ta ketë të lehtë orientimin për votimin e subjektit zgjedhor dhe të kandidatit të parapëlqyer".

Pra, ligji krijon një hapësirë për alternativë vendimmarrëse për organet publike në raste përjashtimore. Organi publik duhet të respektojë dispozitat e përcaktuara në nenin 11 të K.Pr.Administrative nëse është i autorizuar të zgjedhë midis dy ose më shumë alternativave të ligjshme gjatë zbatimit të ligjit në një rast të veçantë. Në lidhje me kushtet që duhet të plotësohen për të ushtruar diskrecionin nga ana e organit publik, argumentojmë se:

a. Diskrecion i parashikuar me ligj (shkronja "a")

Dispozita e parashikuar në shkronjën "a" nuk ka të bëjë me ushtrimin e diskrecionit si të tillë, por me parakushtin e dhënies së pushtetit diskrecionar. Norma e zbatueshme duhet të analizohet nëse ajo ka dhënë apo jo diskrecion. Në shumicën e rasteve formulimi i ligjit tregon qartazi vendimin që duhet të merret. Në rast të kundërt, nëse pasoja ligjore e një norme specifike nuk zbatohet në mënyrë strikte por varet nga një "vlerësim" i organit publik që ka mundësi të zgjedhë ndërmjet zgjidhjeve të ndryshme, atëherë mund të thuhet se norma parashikon diskrecion. Pika 3 e nenit 98 në raport më pikën 1 të po këtij neni të K.Zgjedhor janë rast tipik i diskrecionit të parashikuar në ligj në lidhje me formatimin konkret dhe fletës së votimit sa i përket reflektimit të përmbajtjes në fletën e votimit. Mjafton që të plotësohen kushtet e kërkuara në këtë nen, në mënyrë që të jemi në përputhje me këtë dispozitë.

b. Nuk tejkalon kufijtë e ligjit (shkronja "b")

Dispozita e shkronjës "b" kërkon që organi publik të sigurohet që do të marrë vendimin e tij diskrecionar brenda kufijve të pasojave juridike të ligjit. Neni 98 pika 3 dhe interpretimi më sipër që kemi bërë në lidhje me elementet e fletës së votimit, tregon qartazi se jemi në kushtet kur vendimmarrja e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nuk i tejkalon kufijtë e ligjit, pra jemi brenda kufijve të ligjit.

c. Nuk tejkalon objektivin e ligjit (shkronja "c")

Dispozita e parashikuar në shkronjën "c" përbën parakushtin për ushtrimin e diskrecionit. Organi publik duhet të marrë parasysh objektivat ligjore të ligjit diskrecionar dhe duhet të orientojë vendimin drejt arritjes së këtyre objektivave. Duke vepruar në këtë mënyrë, organi publik duhet të vlerësojë rëndësinë e objektivave në rastin e veçantë dhe të marrë parasysh se deri në çfarë mase mund të arrihen objektivat nëpërmjet zgjidhjeve të dhëna. Edhe sa i

përket këtij kushti, fleta e votimit e miratuar me vendimin objekt i këtij shqyrtimi administrativ, nuk e tejkalon objektivin e ligjit, përkundrazi fleta e miratuar orienton votuesin edhe drejt subjektit zgjedhor që ka propozuar kandidatin përkatës për kryetar të njësisë vendore.

d. Asnjë shmangie e pajustificuar në raport me rastet e njëjta ose të ngjashme (shkronja “ç”)

Ky është një kusht i domosdoshëm për shkak të parimit të barazisë siç parashikohet në nenin 18 të Kushtetutës dhe vetë nenin 17 të K.Pr.Administrative, ku organi publik nuk duhet të përdorë fuqinë e tij diskrecionare për të trajtuar çështje të njëjta në mënyra të ndryshme pa arsye thelbësore. Këtu vlen për t’u theksuar se në zgjedhjet e pjesshme për organet e qeverisjes vendore të datës 6 mars 2022, fleta e votimit për kryetarin e njësisë së qeverisjes vendore e përmbante siglën e subjektit zgjedhor që kishte propozuar kandidatin për kryetar dhe ato janë zgjedhjet më të afërta të radhës që janë zhvilluar për organet e qeverisjes vendore. Ndaj edhe sa i përket kësaj pike mund të themi që në vendimmarrjen e Komisionerit nuk ka asnjë shmangie të pajustificuar në raport me rastin më të fundit të zgjedhjeve të qeverisjes vendore.

Pikërisht kjo analizë e detajuar që i bëmë vendimmarrjes konkrete të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve në raport me nenin 11 të K.Pr.Administrative që parashikon parimin e ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit, na çon në përfundimin që fleta e votimit e miratuar me vendimet objekt i këtij shqyrtimi administrativ është tërësisht në përputhje me këtë parim.

Ajo se çka mund të analizonte KAS në rastin objekt shqyrtimi administrativ, ishte vetëm kontrolli nëse fleta e votimit e miratuar nga Komisioneri kishte të meta formale dhe pala ankimuese dështoi të argumentonte dhe aq më pak të provonte se fletët e votimit objekt shqyrtimi administrativ kishin të meta formale në kundërshtim me parashikimet në K.Zgjedhor.

Këtu vlen të theksojmë edhe arsyetimin e Kolegjit Zgjedhor në vendimin nr. 5, datë 04.04.2021 ku ka arsyetuar:

18. Sa i përket pretendimeve të paditësit në lidhje me paligjshmërinë e vendimit nr.19, datë 3.4.2021 të KAS për ndryshimin e vendimit nr.198, datë 1.4.2021 të KSHZ në lidhje me fletën e votimit, Kolegji e gjen me vend të theksojë paraprakisht se kompetenca lëndore dhe funksionale e Kolegjit, nuk shtrihet në vlerësimin subjektiv të gjyqimeve dhe vlerësimeve diskrecionale të KSHZ, të cilat nuk provohet se dëmtojnë procesin zgjedhor. **KSHZ-së i është ngarkuar detyra e menaxhimit konkret të procesit zgjedhor, nga pikëpamja administrative dhe për rrjedhojë ai në ushtrimin e detyrës së tij, ka përgjegjësinë të marrë edhe vendime me karakter diskrecionar. Në nenin 12(3) të Kodit Zgjedhor është parashikuar se: “[k]omisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve (Komisioneri) është organ monokratik, që ushtron kompetencat ekzekutive, drejton administratën e KQZ-së dhe përfaqëson KQZ-në në marrëdhëniet me të tretët.” Ndaj është krejt e natyrshme që gjatë ushtrimit të kompetencave ekzekutive, Komisioneri të ushtrojë një hapësirë diskrecioni, në kuptim të nenit 3(3) të Kodit të Procedurave Administrative i cili parashikon se: “[d]iskrecioni i organit publik” është e drejta e këtij të fundit për të ushtruar autoritet publik për të përmbushur një qëllim të ligjshëm, në rastet kur ligji parashikon pjesërisht modalitetet për të arritur këtë, duke i dhënë hapësirë vlerësimi zgjedhjeve të organit publik.” Si rregull Kolegji nuk mund të rrëzojë vlerësimet e KSHZ-së bazuar vetëm në hamendësime apo vlerësime subjektive të ndryshme të të njëjtave fakte, pa pasur të paraqitura prova konkrete që nxjerrin në pah shkelje ligjore të vendimeve të KSHZ-së. **Natyrisht që fletët e votimit janë provë në vetvete për zgjedhjen e bërë nga KSHZ dhe KAS e Kolegji mund t’i vlerësojnë ato vetëm në drejtim të evidentimit të shkeljeve potenciale ligjore, për të cilat janë ankuar palët, e që ndikojnë rëndë në procesin zgjedhor.****

...

25. Kolegji i gjen të mbështetura në ligj të dy përmbajtjet e fletëve të votimit, si asaj të miratuar nga KSHZ ashtu edhe asaj të miratuar nga KAS, por vlerëson se, nëse nuk do të kishte të meta formale (përmasat e fletës së votimit në kundërshtim me aktet nënligjore në fuqi) organet e ankimit duhej të kishin respektuar diskrecionin e Komisionerit, sa kohë që nuk provohej qartazi se zgjedhja e Komisionerit ishte në kundërshtim me ligjin dhe dëmtonte rëndë procesin zgjedhor”.

Si përfundim, si K.Zgjedhor, po ashtu dhe K.Pr.Administrative së bashku me jurisprudencën e Kolegjit Zgjedhor e pamundësojnë KAS që të ndërhyjë në fletën e votimit për aq kohë sa në fletën objekt shqyrtimi administrativ nuk ka asnjë element në kundërshtim me ligjin.

6. Objektivi në kompozimin e fletës së votimit është që të hartohet një fletë votimi që e bën sa më të qartë ofertën dhe alternativat konkurruese, që shmang mundësitë e konfundimit të zgjedhësve dhe që e bën sa më të thjeshtë votimin dhe sa më të kuptueshëm vullnetin e zgjedhësve. KAS-i është shprehur edhe në vendimin e tij nr. 19, datë 03.04.2021 se *“sa i përket kompozimit të fletës së votimit, interesi i zgjedhësve është interes madhor në raport me interesin e subjekteve zgjedhore dhe të kandidatëve të tyre. Fleta e votimit nuk është në shërbim të subjekteve dhe kandidatëve, por është në shërbim të drejtpërdrejtë të zgjedhësve ... Interesat e subjekteve dhe të kandidatëve të tyre nuk janë domosdoshmërisht në harmoni me interesin e votuesve në këtë pikë ... Për këtë arsye, KQZ-ja nuk mund të vendosë si objektiv konsensusin publik apo midis subjekteve zgjedhore kur kompozon fletën e votimit, por duhet të kujdeset që të plotësojë pa kompromis nevojat e votuesve për fletë votimi të thjeshtë, të qartë, të kuptueshme dhe të lehtë në orientim”.*
7. Sigla e subjektit përbri emrit të kandidatit përkatës në votimin për kryetarin e bashkisë është informacion i rëndësishëm për zgjedhësit. Lidhja midis subjektit zgjedhor dhe kandidatit të vet evidentohet edhe nga elementët e tjerë dallues, emri i subjektit zgjedhor dhe shkronjat e tij nistore, por sigla e bën përkatësinë më të dallueshme. Këtë gjë e konfirmon edhe ankuesi nëpërmjet kërkesës së tij. Qëllimi i kërkesës për heqjen e siglës, i deklaruar në seancë, është që të dobësohet lidhja e kandidatit me subjektin zgjedhor propozues. Ky qëllim vjen në kundërshtim me interesin më të lartë të zgjedhësit, prandaj kërkesa nuk mund të konsiderohet e ligjshme nga KAS-i.
8. Argumenti i dytë i ankuesit në seancë ishte se prania e siglës në fletën e votimit konfondon zgjedhësit, pasi sigla e përafron votimin e mazhoritarit me atë të proporcionalit. Zgjedhësit nuk votojnë kandidatin, por votojnë më tepër subjektin zgjedhor që e mbështet. Ky argument, sikurse ka theksuar Kolegji Zgjedhor Gjyqësor me vendimin e tij nr. 5, datë 04.04.2021, ka nevojë të provohet që të mund të pranohet si i faktuar. Gjithsesi, fakti që në votimin për këshillin bashkiak marrin pjesë, si rregull, një numër i lartë subjektësh, kurse në

votimin për kryetarin e bashkisë ky numër është i reduktuar, mund të konsiderohet si element që i dallon mjaftueshëm dy fletët e votimit dhe dy votimet nga njeri tjetri.

9. Nga elementët e përcaktuar nga fjalia e dytë e pikës 3 të nenit 98, fletës së votimit të miratuar i mungon emri i kryetarit të partisë ose të partisë udhëheqëse të koalicionit. KAS dhe Kolegji Zgjedhor kanë argumentuar se edhe ky element identifikues është element detyrues. Por KAS-i nuk mund të urdhërojë përfshirjen e tij në fletën e votimit, sepse përfaqësuesi i palës së interesuar, Partia Demokratike u tërhoq në seancë nga kërkesa për përfshirjen e emrit të kryetarit të partisë në fletën e votimit.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenet 21 pika 1 shkronja “b” dhe 143 pika 1 shkronja “b” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në emër të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, KAS, me shumicë votash

V E N D O S I:

1. Rrëzimin e kërkesës ankimore të paraqitur nga koalicioni “Bashkë Fitojmë”.
2. Lënien në fuqi të vendimit nr. 360, datë 15.04.2023 dhe vendimit nr. 363, datë 15.04.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Administrativ brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Ledio BRAHO - **Relator**

Elvin LAKO - **Anëtar**

Elvis ÇEFA - **Anëtar (Kundër)**

Ilirjan RUSMALI - **Anëtar**

Koli BELE - **Anëtar**